



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Prill 2021

Nr. 270

**VENDIM**

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të qytetarit për shkelje të parashikuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi
- Kërkues:** Denoncues
- Ndaj:** Kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi
- Baza Ligjore:** Nenet 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23 dhe 24 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 të Komisionit Rregullator, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë shqyrtimit administrativ,

**VËREN:**

**I.Vlerësimi Paraprak**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën e email-it: [denoncime.kqz@gmail.com](mailto:denoncime.kqz@gmail.com), është raportuar denoncimi i qytetarit, administruar nga KQZ me nr. 3181 prot., datë 3.4.2021, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi. Referuar denoncimit, denoncuesi shprehet se “Shkelja ligjore që dua të informojë është se në zonën e Gjirokastrës ka furgona me banderolën e Bledi Cucit. Kjo është shkelje e hapur pasi qytetarët janë të lirë të zgjedhin.” Bashkëlidhur këtij denoncimi, qytetari ka



paraqitur edhe një foto në të cilën mbështet denoncimin e tij si dhe një link të medias lokale “Channel-7.net” në të cilën pretendon se është publikuar fakti i denoncuar prej tij.

Referuar nenit 23 të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, “*Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.*”

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar pikës 4 të nenit 6 të vendimit nr. 9/2021 “Për procedurat e funksionimit dhe portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” parashikohet se:

***“Denoncuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim por denoncimi i tij do të pranohet për shqyrtim, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit, si dhe informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht, shkeljet e mundshme.”***

Për sa më sipër, marrë në konsideratë faktin se në denoncimin e tij, denoncuesi në fjalë ka kërkuar të mbetet anonim duke dhënë dhe arsyen objektive përse kërkon të mbetet i tillë, gjeneralitetet e tij, gjatë shqyrtimit të këtij denoncimi, do të mbeten anonim.

## II. Rrethanat e faktit



Data: 21 Prill 2021  
Nr. 270

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, të qytetarit për shkelje të parashikuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi

Në datën 23.03.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka miratuar udhëzimin nr. 6 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Në datën 31.03.2021 , në adresën e email-it: [denoncime.kqz@gmail.com](mailto:denoncime.kqz@gmail.com), është raportuar denoncimi i administruar nga KQZ me nr. 3181 prot., datë 3.4.2021, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi, për faktin se në zonën e Gjirokastrës ka furgona me banderolën e tij. Denoncuesi nuk ka përcaktuar asnjë bazë të mundshme ligjore si shkelje të pretenduar por veç faktit të mësipërm ka vendosur në dispozicion një foto dhe një link të televizionit lokal “Channel-7.net” në të cilën mbështet pretendimet e tij.

### III. Analiza ligjore

Në vlerësim të provave dhe fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se:

Referuar pikës 3 të nenit 3 të udhëzimit nr.6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Ndalohet vendosja e materialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik”.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara në këtë denoncim, KQZ arrin në përfundimin se, mjete i transportit, në foton bashkëlidhur këtij denoncimi nuk konkludon dot nëse është mjet i transportit publik, për rrjedhojë, nuk rezulton e provuar se fakti i pretenduar nga denoncuesi është në shkelje të kushtit nënligjor përcaktuar nga udhëzimi nr. 6/2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për denoncimin e kryer nga qytetari pasi në përfundim të shqyrtimit paraprak rezulton se, veprimtaria e kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në udhëzimin nr. 6/2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23 dhe 24 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 të



Komisionit Rregullator, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

**V E N D O S:**

1. Mosfillimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 21 Prill 2021  
Nr. 270

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, të qytetarit për shkelje të parashikuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi